

MENAXHIMI DHE RREGULLIMI I DOKUMENTACIONIT ARKIVOR NË ARKIVIN
NDËRKOMUNAL TË PEJËS

TEMA PËR TITULLIN

MASTER I HISTORISË – PROGRAMI ARKIVISTIKË

NGA

TEUTA GASHI



UNIVERSITETI I PRISHTINËS

FAKULTETI FILOZOFIK

DEPARTAMENTI I HISTORISË – PROGRAMI ARKIVISTIKË

PRISHTINË

DHJETOR, 2022

MENAXHIMI DHE RREGULLIMI I DOKUMENTACIONIT ARKIVOR NË ARKIVIN NDËRKOMUNAL TË PEJËS

Nga

TEUTA GASHI

Mentor: Prof. Asoc. Dr. Muhamet Qerimi

Në Kosovë kemi një zhvillim të vonshëm të arkivave, por kjo nuk do të thotë që arkivat në vendin tonë të mos përcjellin zhvillimet më të reja në fushën e krijimit, menaxhimit, rregullimit përpunimit dhe ruajtjes së dokumenteve në bartësit letër dhe digjital. Arkivi institucion në mes të kaluarës dhe të ardhmes është një pikë referimi për kujtesën njerëzore, para së gjithash kur është fjala për vlerësim lidhur me një vendim në favor të dokumenteve të cilat ruhen përgjithmonë. Historiku i zhvillimit të arkivit të Pejës është pjesë e pandarë e zhvillimit të arkivave të Kosovës në përgjithësi, ndërsa tema “Menaxhimi dhe rregullimi i dokumentacionit arkivor në Arkivin Ndërkomunal të Pejës” është bërë në bazë të rëndësisë së tij si një temë ku trajtohen rrethanat që nga periudha e krijimit të këtij institucioni.

Ky punim është me interes profesional, sepse kemi të bëjmë me historikun, rëndësinë dhe plotësimin e standardëve ndërkombëtare të një arkivi institucional. Punimi në mes tjerash trajton çështjet të lidhura me “Menaxhimi dhe rregullimin e dokumentacionit arkivor në Arkivin Ndërkomunal të Pejës” që nga krijimi i tij si institucion shtetëror me karakter juridik dhe fizik, pastaj për shërbimin mbrojtës, fondet arkivore të kësaj komune si dhe dokumentet kulturore. Një vëmendje e veçantë i është kushtuar historikut të arkivit që nga themelimi i tij si institucion, dhe sa në të vërtetë ky institucion i përdorë standardet ndërkombëtare. Si për mënyrën e pranimin dhe mbrojtjes së lëndës arkivore, po ashtu edhe dokumenteve me karakter kulturor, duke dhënë informacione të përgjithshme mbi teorinë bashkëkohore të përcaktimit të këtij institucioni me një rëndësi të veçantë historike dhe kulturore të një populli. Gjithashtu, me krijimin e fondit arkivor si dhe me koleksionet, me studimin e përmbajtjes së dokumenteve, me sistematizimin dhe klasifikimin e lëndës arkivore si dhe me teknologjinë e ruajtjes së dokumenteve.

Punimin e kemi ndarë në tre kapituj. Në kapitullin e parë kemi trajtuar në pika të shkurtra për rëndësinë që kanë arkivat, jo vetëm për historinë, por në përgjithësi për gjeneratat që vijnë. Për

historikun e arkivit të Pejës, dhe për procesverbalin mbi pranimin dhe dorëzimin e dokumenteve arkivore. Kapitulli i dytë rëndësinë e arkivave në përgjithësi dhe veçanërisht në plotësimin e standardëve ndërkombëtare të Arkivit Ndërkomunal të Pejës. Mënyra se si bëhet menaxhimi i dokumenteve brenda arkivit. Si dhe për ndryshimet në legjislacionin arkivor në Kosovë, ndërsa kapitulli i tretë trajton lëndët arkivore që gjenden brenda Arkivit Ndërkomunal të Pejës. Për mënyrën e krijimit të tyre, si dhe rëndësinë e tyre. Mënyra se si duhet të bëhet vlerësimi i dokumenteve dhe listat e afatit të ruajtjes së lëndës arkivore. Dhe në fund për mënyrën se si duhet të qasëmi në lëndët arkivore.

Menaxhimi dhe rregullimi i dokumenteve në këtë arkiv nuk është bërë vetëm për të menaxhuar krijimin e arkivave, por edhe për të shfrytëzuar informacionin e mbajtur në të dhënat në mënyrë sa më efektive. Është thelbësore që për të menaxhuar të dhënat për të mirën e organizatës, është i pamundur një shërbim funksional, nëse nuk ka një dimension arkivor për të menaxhuar të dhënat, që ruajnë dhe e bëjnë të arritshme atë. Duke u bazuar në shfrytëzimin e literaturës gjithnjë në interes të përpilimit të këtij punimi, që për temë kishte Menaxhimin dhe rregullimin e dokumentacionit arkivore në arkivin Ndërkomunal të Pejës, arrijmë të kolloidjmë se në periudhën e vitit 1968 është themeluar Arkivi i Pejës me një vendim të institucioneve relevante të asaj kohë. Historiku i zhvillimit të Arkivit Regjional të Pejës është pjesë e pandarë e zhvillimit të arkivave të Kosovës në përgjithësi. Punimi përfundon me konkluzione dhe rekomandime.